



Dalës-Izlazna

Nr. 1-52  
Br.

Data 15.04.2022  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opština Obilic - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.18.03.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana dhe Linda Sadiku

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së për marrjen e vendimit për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42 €,
4. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerën prej 368,930.24 €,
5. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.-I-94, e dt.29.06.2018 për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale
6. Shqyrtimi i kërkesës për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 4 vota për dhe 2 vota abstenim.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Nazlije Shala pa arsye

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 3 vota për dhe 2 vota kundër.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për marrjen e vendimit për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42 €.

**Zarife Behluli** – Ju sqaroj se në faqen e parë i keni mjetet ku kanë mbetë nga viti 2021. Planifikimi i buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2021 ka qenë 950,180 €. Ne kemi arritë me i tejkalue 225,251.42 €, dhe total të hyra nga tatimet, taksa e tarifa që kanë pasë me i pague qytetarët dhe bizneset janë 105,098.12, ndërsa nga gjobat dhe denimet në trafik pas çdo 3 mujori alokohen nëpër Komuna. Në mbylljen e vitit këto janë alokue në janar janë 120,153 €. Totali 105,098.12 €, dhe 120,153.30 €, bëjnë 225,251.42 €. Vendimi i parë duhet të merret për rritjen e të hyrave vetanake në këtë vlerë.

**Enver Gashi** – Është një dukuri e mirë kur Komuna mbledhë të hyra vetanake më shumë se që ka planifikue dhe dëshiron që ta rritë kuotën, e admiroj dhe ne si grup jemi për.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jo që jemi kundër diçka, por jemi për me shkue kjo pikë e rendit të ditës në Kuvend, pastaj atje i bisedojmë të gjitha specifikat.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e kërkesës së DEFZH-së, për marrjen e vendimit për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 225,251.42 €.**

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerën prej 368,930 €.

**Zarife Behluli** – Sqaron se në materialin që e keni në faqen e parë janë mjetet që kanë qenë të alokuara në sistem dhe që kanë mbetë pjesë të vogla që janë krye punët. Kjo, është buxheti, shpenzimi dhe të lira janë 143,678.82 €. Kësaj vlere ia shtojmë tash edhe rritjen e të hyrave 225,251.42 €, dhe në total për bartjen në vitin 2022 janë 368,930.24. Tani, ju tregoj se ku do të shkojnë këto mjete, prej 225.251.42 nga rritja e të hyrave ndërtimi i bibliotekës 22,855.19 €, inventar për Shtëpi të kulturës 1,661.50 €, te hartat zonale 50,734 €, subvencione në Arsim 150,000 €, për bursa nxënësve dhe studentëve. Në total vlera është 225,251.42 €. Tani, shkojmë te mjetet e mbetura, te ndërtimi i bibliotekës 7,010 €, mallra, mbjellja e drunjëve 11,295.77 €, nga komunalitë 69,849.50 €, subvencione për bujqësi 27,394.60 €, te asfaltimi i rrugëve 10,575 €, rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit edhe këto kanë qenë te kjo vijë dhe mbeten te kjo vijë. Në total janë 143,678.82 €. Për Drejtorinë e kulturës, ju sqaroj se nga janë marrë mjetet, te blerja e inventarit kanë mbetë 51 €, që shkojnë prapë te Drejtoria e kulturës, ndriçimi publik 512.52 €, renovimi i objekteve QKPF, AMF dhe QMF 5,047.74, pajisje elektrike ne QKMF, AMF dhe QMF 1,320, shtruarja e rrugëve me zhavorr 5.90, ndërtimi i shtatoreve në Obiliq 25.40 €, ndërtimi i anekseve shkollore në Obiliq 47.73 €, që në total 7,010.29 €, shkon te ndërtimi i bibliotekës plus ajo rritja e të hyrave te ndërtimi i bibliotekës janë 29,865.48 €. Për planifikimin mjedisor, nga administrata komunale prej mallrave kanë mbetë 40 €, nga DSHPE-ja, 135 €, kujdesi primar shëndetësor 2 €, çerdhja 3,336.42 €, zyra e Kryetarit 143.50 €, mallrat në mjedis që kanë mbetë 33.85. Tash, këto janë fondi 21 dhe fondi 22, që nga fondi 22, 1,418.13, DSHPE-ja, 5,096.17 €, zyra e Kryetarit 1,018.45 €, mjete të mjedisit që kanë qenë 1,018.45 €, shkojnë prej mallrave 11,295.77 €, te mbjellja e drunjëve. Nga shpenzimet komunale, kujdesi primar shëndetësor 3,000 €, qerdhja 1,000 €, Arsimi fillor 2,000 €, dhe mjedisi mjete të veta 19,675 €, DSHPE-ja, 44,174.50 €, mjetet nga shpenzimet komunale kalojnë te mbjellja e drunjëve 69,849.50 €, plus këto prej mallrave 81,145.27 €, në mbjelljen e drunjëve, që është projekti i tenderuar dhe vetëm vazhdojnë punimet. Për bujqësinë nga subvencionet dhe transferet nga fondi 21, zyra e Kryetarit 245 €, DSHPE-ja, 14,795.30 €, buxheti 5,100 €, Arsimi 40 €, mjetet e bujqësisë të mbetura 5,650.89 €, në total 25,831.19 €. Nga fondi 22, zyra e Kryetarit 99.27 €, DSHPE-ja 58.70 €, Arsimi 40 €, mjete bujqësia që i ka pasë në vijën e vet 1,365.44 €, në total 1,563.41 €, plus 25.831.19 €, 27,394 kalojnë në subvencione te bujqësia.

**Sami Ahmeti** – Faleminderit prej drejtoreshës edhe pse nuk pati nevojë me na i shpjegue të gjitha se duhet me u përgatitë për seancë. Ne jemi për me rekomandue këtë pikë të rendit të ditës për seancën e ardhshme.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerën prej 368,930 €.**

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti plotësim ndryshimin e Rregullores nr.-I-94 të dt.29.06.2018, për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale.

**Sami Ahmeti** – Unë e kam lexuar këtë Rregullore dhe kam pyetjet dhe vërejtjet e mia, megjithatë këto do ti qfaq i në séance. Ne jemi për atë që kjo pikë të shkoj në seancë.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal daljen në debat publik për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.-I-94, e dt.29.06.2018, për tarifa, gjoba dhe ngarkesa komunale.**

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për mennaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal daljen në debat publik për plotësim ndryshimin e Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në**

## **Komunën e Obiliqit.**

### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga MFPT për shfuqizim të vendimit nr.-I-16, të dt.31.01.2022, për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

**Sami Ahmeti** – Neve, realisht nuk na ka ardhë asnjë kërkesë me materialin që e kemi marrë, prandaj edhe kjo kërkesë do të ishte mirë që të na përcjellet në email, në mënyrë që të dijmë se për çka bëhet fjalë sepse këtu po fliten shumë numra dhe shumë gjëra që ne nuk mundemi me i kapë të gjitha automatikisht. Sido që të jetë e kuptoj se është bërë një vendim për tatimet pa e konsultuar ligjin sepse është dashur që ky vendim të merret në vitin e kaluar. Mirëpo, pse ka qenë vit zgjedhor sa e di unë Kuvendi ka funksionue, ka mund të bëhet, por kjo është mos të them një shkelje, nuk është një neglizhim, ju ka kalue dhe nuk keni marrë vendim. Ne nuk kemi kurgjë kundër që kjo të shkon në seancë, apo si e shihni ju të arsyeshme sepse edhe kështu qenka anulue ky vendim.

**Enver Gashi** – Kjo duhet patjetër të shkoj në seancë të Kuvendit dhe ne jemi për atë që të shkoj kjo çështje në Kuvend, të shfuqizohet ky vendim sepse është marrë me vonesë dhe të vazhdojmë me tarifat e vitit 2021.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesën nga MFPT, nr.-VI-020-134/6, e dt.07.03.2022, për shfuqizim të vendimit nr.-I-16, të dt.31.01.2022.**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për shfuqizim të vendimit nr.-I- 17, i dt.31.01.2022, me të cilin bëhet plotësimi dhe ndryshimi i vendimit nr. –I-67, i dt.25.04.2019, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim, për familjet që janë raste sociale.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesa nga kërkesën nga MMPHI-ja, nr. –VI-020-460/12, të dt. 10.03.2022, për shfuqizim të vendimit nr.-I-17, të dt.31.01.2022.**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për shfuqizim të vendimit nr. -I-18, i dt.31.01.2022, me të cilin bëhet plotësimi dhe ndryshimi i vendimit nr.I-102, i dt.04.08.2021, i Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta me anëtarë të rinjë.

**Sami Ahmeti** – Unë kam veç një lutje nëse, ka mundësi që këto kërkesa të na i përcjellni në emai. Ndërsa, sa i përket kësaj që të bisedohet në Kuvendin komunal, gjithsesi jemi që të shfuqizohet vendimi, por më çudit fakti qysh qe 2 mandate kanë qenë në pushtet dhe nuk kanë arritë me kuptue se kush i bën Komisionet. Sipas kësaj po duket se Kryetari po don që përgjegjësitë e veta me ia hedhë Kuvendit komunal, por ka qenë kompetencë e tij. As unë nuk e kam ditë deri sot që këto Komisione i bën Kryetari, apo Kuvendi sepse nuk e kam lexuar një diçka të tillë. Megjithatë, kjo nuk do të pritej prej një Kryetari që është në mandatin e tretë.

**Enver Gashi** – Sqaron se unë kam qenë anëtar i Kuvendit të legjislaturës së kaluar dhe ne Komisionin e kemi formuar në Kuvend, por asnjë vendim nuk bëhet pa e miratuar MAPL-ja. Tash, ka ndryshue diçka dhe ne duhet konform ligjeve e Rregulloreve, të veprojmë. Kjo, nuk është punë e Kryetarit, as legjislaturës, por është ndryshuar dhe po ashtu ne ashtu veprojmë.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesa nga kërkesën nga MMPHI-ja, nr.-VI-020-460/13, të dt.10.03.2022, për shfuqizim të vendimit nr.-I-18, të dt.31.01.2022.**

### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** - Unë i kam 3 kërkesa për seancën e ardhshme të Kuvendit, që të bisedohet në pikën “Të ndryshme” që drejtori i shëndetësisë, apo ai i QKMF-së, të vjen në seancë dhe të na informoj për gjendjen në sistemin shëndetësor, stafin, kushtet e tyre, nivelin e shërbimeve në QKMF, në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, Po ashtu, për shpenzimet, sfidat, të jenë të hapur edhe për pyetjet tjera, që do të bëhen nga anëtarët e Kuvendit komunal. Neve, na interesojnë edhe kushtet e punës dhe gjendja e Qendrës për mirëqenie sociale, që është në kuadër të kësaj Drejtorie. Kërkesa e dytë është drejtori i Arsimit, të na sjellë informata për gjendjen në Arsim në Komunën tonë, vlerësimet, siguria në institucion, kushtet e punës, kabinetet, sistematizimi i mësimdhënësve, normat e tyre dhe sfidat. Po ashtu, drejtori të jetë i gatshëm të përgjegjet në pyetjet tjera të

anëtarëve të Kuvendit komunal. Kërkesa e 3, është që drejtori i infrastrukturës të vjen dhe të na informoj për gjendjen në këtë Drejtori, projektet që janë përmbyllë në këtë vit, projektet që janë duke u zhvilluar dhe që do të zhvillohen në këtë vit, mbarëvajtja e projekteve, a po i respektojnë punëkryesit kushtet sipas kontratës etj. Gjithashtu, edhe nga ky drejtor kërkojmë që të jetë i gatshëm dhe të iu përgjegjet pyetjeve të Kuvendit. Këto, janë 3 kërkesa që grupi ynë parlamentar kërkon nga drejtorët e këtij Ekzekutivi, që të na japin disa sqarime.

**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, kërkesat tuaja do të adresohen në Drejtoritë përkatëse.

Para se ta mbyllë seancën kërkoj nga anëtarët e vjetër të Kuvendit, që ti dorëzojnë kartelat sepse nuk po mundemi ti kompletojmë të gjitha kartelat dhe të shkojnë të fotografohen sepse disa ende nuk kanë bërë foto, s'po mundën të iu merren të dhënat dhe Kuvendi nuk po mund të kompletohet me të gjitha gjërat.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:32'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

